

Analiza Financiare

Dep.: Kontabilitet dhe Financa

MSc. Valdrin Misiri



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Analiza Financiare

- Viti III-të, Semestri VI
 - Departamenti : KF
 - Statusi i lëndes : Zgjedhore
 - Javët mësimore: 15 [2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime]
 - Mësimdhënes: Prof.Asoc.Dr. Rustem Asllanaj
 - Asistent: MSc. Valdrin Misiri
 - Orari i ushtrimeve: E hene (G1 – ora 09:45 - 11:15 A3)
-
- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
 - Website: www.unhz.weebly.com

Çmuarja e pasurise se ndermarrjes si parakusht per ruajtjen e vleres se saj

- Parimet e bilancimit ne funksion te ruajtjes se pasurise se ndermarrjes
- Çmuarja e pasurise se ndermarrjes
 - Parimet e çmuarjes se pasurise se ndermarrjes
 - Çmuarja e mjeteve kryesore
 - Çmuarja e rezervave

Parimet e bilancimit ne funksion ruajtjes se pasurise se ndermarrjes

- Veprimtaria e ndermarrjes mund të paraqitet ne forma te ndryshme prandaj është e pamundur që tërë ajo të rregullohet me dispozita ligjore.
- Parimet e bilancimit janë në të vërtetë rregulla principele të shprehjes se bilancit dhe percaktimit të vlerës së pozicioneve të bilancit
- Bazën për të gjitha parimet e bilancimit, gjegjësisht të kontabilitetit në përgjithësi e paraqesin postulatet e bilancimit

...Postulatat e bilancimit

- *Postulatet janë propozime të pakta dhe kryesore në të cilat mbështeten parimet, ato gjithsesi dalin nga mjedisi ekonomik dhe politik, si dhe nga menyra e te menduarit dhe e zakoneve të të gjitha segmenteve të bashkësisë ekonomike.*
- *Nderkaq profesioni duhet ta qartësojë kuptimin dhe interpretimin e tyre duke siguruar një bazë të mirë për formulimin e parimeve dhe zhvillimin e rregullave dhe të udhëzimeve për zbatimin e parimeve në situata specifike*

Parimet e bilancimit

- Parimet e bilancimit nga autorë të ndryshëm klasifikohen në mënyra të ndryshme.
- Mirëpo të gjitha parimet e bilancimit, si ato ekzistuese ashtu edhe parimet alternative, të cilat mund të ngrihen, duhet t'i kënaqin tri kritere kryesore.
- Këto janë:
 - Relevantiteti,
 - Objektiviteti
 - Zbatueshmëria.

Parimet e bilancimit

- Prej parimeve të bilancimit, të cilat janë më të rëndësishmet për çmuarjen e mjeteve dhe të burimeve të mjeteve, në bilancin e rregullt të afarizmit të ndërmarrjes mund të veçohen:
 - Parimi i veshtisë
 - Parimi (koncepti) i matjes monetare dhe i hulumtimit të vlerës
 - Parimi i entitetit të subjektit afarist
 - Parimi i kontinuitetit (përhershmerisë) të subjektit ekonomik
 - Parimi i shpenzimeve të vërteta (historike)
 - Parimi i shkakësisë (korelacionit) dhe
 - Parimi i konsistentitetit

Parimi i veshtisë

- Parimi i veshtisë është njëri prej parimeve kryesore të bilancimit. Ai gjen shprehje sidomos kur ekziston veprimi inflator në ekonomi dhe kur ndërmarrja duhet të krijojë aso mundësisë që do të siguronin mbulimin e humbjeve eventuale.
- Prandaj *“Parimi i veshtisë parakupton hartimin e atillë të bilancit që i merr parasysh të gjitha të papriturat dhe befasitë negative që mund t’i dalin ndërmarrjes gjatë veprimtarisë së saj”*

Nënparimet e parimit të veshtisë

- **Parimi i realizimit** – fitimet dhe humbjet nuk mund të konstatohen para momentit të realizimit
- **Parimi i imparitetet** – paraqitja dhe perfshirja e të gjitha humbjeve të mundshme edhe pse nuk janë verifikuar në treg
- **Parimi i cmimeve më të ulëta** – vlerësimi bëhet sipas cmimeve të furnizimit apo sipas cmimit kushtues, por me kusht që këto cmime mos të jenë më të larta se cmimet ekzistuese ne treg
- **Parimi i cmimeve ditore** – ky parim zbatohet vetem atëherë kur e tërë pasuria e ndërmarrjes nxirret në pazar.
- **Parimi i cmimeve më të larta** – për bilancimin e zërave të pasivit

Parimi i entitetit

- Sipas këtij parimi, subjekti afarist, gjegjësisht tërësia kontabile është entitet për vete, njësi me të drejtat dhe obligimet e veta, e ndarë nga pronari, nga partnerët afaristë dhe financiarë, nga punëtorët, nga investuesit dhe të interesuarit e tjerë për punën dhe suksesin e saj.

Parimi i kontinuitetit

- Nënkupton që ndërmarrja themelohet për një veprimtari e cila do të vazhdojë pa ndërprerje dhe me një afat të pacaktuar.
- Mirëpo në këtë afat të pacaktuar të veprimtarisë së ndërmarrjes është e domosdoshme që në mënyrë permanente të bëhet bilancimi periodik së paku një here ne vit me qellim që të jepet llogari si bazë për qeverisjen e ndërmarrjes.

Parimi i shkakësisë apo korelacionit

- Kërkon që me rastin e përllogaritjes së rezultatit periodik, të hyrave t'u bashkangjiten të gjitha të hyrat, ndërkaq të dalave të gjitha të dalat, të cilat kanë ndodhur në periudhën përllogaritese dhe që ato të pasqyrohen në bilancin e suksesit.
- Në këtë mënyrë bëhet korelacioni i të hyrave dhe i të dalave.

Parimi i konsistentitetit

- Kërkon që kur të qasën raportet kontabel në bilancin e suksesit të rezultateve periodike, parimet e bilancimit, të zgjedhura njëherë, të zbatohen në mënyrë konsekuente prej një periudhe në tjetren, gjegjësisht deri atëherë kur nuk krijohen shkaqet e arsyeshme për përmirësimin e mënyrës së bilancimit.

Çmuarja e pasurisë së ndërmarrjes

- Parimet e çmurajes së pasurisë së ndërmarrjes
- Çmuarja e mjeteve kryesore
- Çmuarja e rezervave

Parimet e çmuarjes së pasurisë së ndërmarrjes

- Çmuarja e pozicioneve të bilancit në të vërtetë është përcaktimi i vlerës së tyre. është e ditur se pasuria e ndërmarrjes në esencë përbën një prej të mirave reale prej kërkesave që mund të jenë në valutë të vendit dhe të huaj, prej letrave me vlerë si dhe prej mjeteve para që gjithashtu mund të jenë në valutë të vendit apo të huaj.

Parimet e çmuarjes së pasurisë së ndërmarrjes

- Pasur parasysh që lidhshmeria e bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit, çmuarja e aktivit, detyrimeve dhe pasivit transitor, nuk pasqyrohet vetem ne bilancin e gjendjes, por edhe në bilancin e suksesit.
- *Për këtë arsye me rastin e çmuarjes nuk është me rëndësi vetem zgjedhja e bazës për çmuarje, por është me rëndësi edhe mënyra e shlyerjes, përlllogaritja e shpenzimeve të materialit dhe konstatimi i cmimit kushtues*

Parimet e çmuarjes së pasurisë së ndërmarrjes

- *Parimi i çmuarjes sipas çmimeve të furnizimit*
- *Parimi i çmuarjes sipas çmimeve ditore dhe*
- *Parimi i çmuarjes sipas çmimit likuidues*

Parimet e çmuarjes së pasurisë së ndërmarrjes

- Sipas çmimeve të furnizimit – Çmuarja e pjesëve të pasurisë bëhet sipas cmimi të blerjes, qoftë të të mirave reale, letrave më vlerë apo devizave.
- Sipas çmimeve ditore – Të gjitha pozicionet e bilancit çmohen sipas cmimit ditor, sepse çmuarja sipas çmimeve ditore ka për qëllim ruajtjen e substancës, pra të pasqyrojë saktësisht gjendjen faktike të pasurisë së ndërmarrjes.
- Sipas çmimit likuidues – ky parim gjenë zbatim, në qoftë se ndërmarrja ndërpren aktivitetin e vet dhe me atë rast e tërë pasuria e saj shëndrrohet në para me qëllim pagimi të detyrimeve ndaj paleve të treta.

Çmuarja e mjeteve kryesore

- Mjetet kryesore ne kuptimin kontabël paraqesin atë pjesë të pasurisë së ndërmarrjes, e cila nuk shëndrrohet në para brenda një viti apo brenda një cikli të prodhimit.
- Në qoftë së bazë për çmuarjen e vlerës së mjeteve kryesore, atëherë vlera e pozicionit bilancor të mjeteve kryesore, varet jo vetëm prej cmimit të furnizimit, por edhe prej natyrës së shlyerjes së mjeteve kryesore, pra prej metodave të perlllogaritjes së amortizimit dhe zhvlerësimit.

Çmuarja e mjeteve kryesore

- Amortizimi apo zhvleresimi i plotë e mjeteve kryesore mund të bëhet më së voni deri atëherë kur është çmuar afat-qëndrushmeria e tyre.
- Me rastin e përlogaritjes së zhvlerësimit apo amortizimit më rëndësi është që të përcaktohen:
 - Baza për amortizim apo zhvleresim
 - Qëllimet e përlogaritjes së zhvlerësimit apo amortizimit
 - Afati i qëndrueshmërisë së mjetit kryesor dhe
 - Metodatat e përlogaritjes së zhvlerësimit apo amortizimit

Çmuarja e mjeteve kryesore

- Si qëllime kryesore të cilat më së shpeshti përmenden lidhur me përllogaritjen e zhvleresimit (amortizimit) janë:
 - Konstatimi dhe paraqitja sa më korrekte e gjendjes dhe e strukturës së pasurisë dhe kapitalit në bilancin e gjendjes
 - Sigurimi i mjeteve monetare për zëvendësimin e mjeteve kryesore të vjetëruara
 - Alokacioni periodik i shpenzimeve të mjeteve kryesore me qëllim të përllogaritjes reale
 - Kënaqja e kërkesave kalkulative të subjektit afarist

Çmuarja e mjeteve kryesore

- Gjatë përlogaritjes së zhvlerësimit është me rëndësi edhe percaktimi i afatit të qëndrimit të mjetit kryesor.
- Në vlerësimin e afatit të qëndrimit të pasurisë fikse, kontabilistet nisen nga ajo se ai është:
 - I kufizuar me veprimin e dy grupeve kryesore të faktorëve: së pari, prishja, shkatërrimi, si dhe format e tjera të vjetërsimit fizik që i sjell përdorimi me kalimin e kohës, dhe së dyti, progresi teknik dhe faktorët ekstern, të cilët e reduktojnë efektivitetin ekonomik të pasurisë fikse ose e bëjnë plotësisht të padobishme.

Çmuarja e mjeteve kryesore

- Prandaj në këtë rast, duhet pasur parasysh veprimin e paqartë të këtyre dy grupeve të faktorëve dhe duhet nisur prej parimit të kujdesit (veshtisë) dhe që afati i qëndrimit të mjetit kryesor të çmohet në formën e tij më pesimiste të optimizimit
- Mirëpo, në këtë rast duhet respektuar edhe parimin e konsistentitetit, sipas të cilit, afati i qëndrimit i përcaktuar një herë për mjetin kryesor nuk mund të ndryshohet pa ndonjë arsye të madhe,

Çmuarja e rezervave

- Për dallim nga mjetet kryesore, rezervat “paraqesin atë pjesë të formës materiale të pasurisë së ndërmarrjes, të cilat në rrjedhen normale afariste janë dedikuar të konvertohen në formen monetare brenda një cikli afarist, respektivisht brenda një viti afarist”
- Parimi i realizimit, në menyre implicite e paraqet kërkesen që të gjitha pozicionet e bilancit të çmohen sipas cmimeve faktike apo sipas shpenzimeve historike

Çmuarja e rezervave

- Sipas parimit të vështisë, sëndërtimi bëhet me respektimin e cmimit më të ulët në krahasim me cmimin ditorë, gjatë bilancimit të rezervave.
- Andaj, bilancimi i rezervave të materialit dhe mallit tregtar, në pajtim me parimin e realizimit , bëhet sipas cmimit të furnizimit, ku si elemente kryesore të cmimit të furnizimit na paraqiten cmimi i fatures, shpenzimet vartëse të furnizimit, sic janë shpenzimet e transportit, sigurimit, dogana, ngarkim-shkarkimi etj,

Çmuarja e rezervave

- Metodat kryesore që kanë të bëjnë me llogaritjen e levizjes së rezervave të materialit dhe të mallit tregtar janë:
 - Metoda e identifikimit të shpenzimeve specifike ose metoda e përlllogaritjes së rezervave në bazë të rrotullimit të tyre fizik apo të rrjedhës së tyre dhe
 - Metoda e përlllogaritjes së rezervave në bazë të prezupozimeve për rrjedhat vlerore.

Çmuarja e rezervave

- Metoda e përlogaritjes së rezervave i jep përparësi rrjedhës fizike të mirave në krahasim me rrjedhen ekonomike apo vlerore.
- Autorët amerikanë W. Paton dhe A. Littleton duke e përkrahur këtë metodë të përlogaritjes së rezervave dhe të konstatimit të rezultatit periodik, kërkojnë që e hyra e një periudhe duhet të jetë ngarkesë me shpenzimet legjitime të lidhura për produktin që prezentohet në atë të hyrë.

Çmuarja e rezervave

- Metoda e llogaritjes së rezervave në bazë të presupozimit të rrjedhave të tyre vlerore, niset nga ideja se rrjedha vlerore apo ekonomike e rezervave, është më e rëndësishme së ajo fizike.
- Në qoftë së është fjala për rezerva homogjene të materialit dhe mallit, të cilat janë furnizuar më cmime të ndryshme dhe kjo ka bërë sot që në kontabilitet të përdorën apo ekzistojnë më shumë metoda të ndryshme për vlerësimin e rezervave.

Çmuarja e rezervave

- Metodat e tilla të cilat tani përdoren janë si:
 - Metoda FIFO
 - Metoda LIFO
 - Metoda KOSME
 - Metoda e rezervave të hekurta
 - Metoda HIFO
 - Dhe metoda të tjera të ngjajshme.

Pyetje



Suksese!